

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT,**  
**INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE INFORMALE, LEZHË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Lezhë, me objekt: *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 150, datë 06.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 561/6, datë 06.12.2013, i ka rekomanduar z. Pashkë Ndoci, Drejtor i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Lezhë, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, për të bashkëngjitur parcelave ndërtimore sipërfaqet e poseduara por të pa llogaritura për pagesë, në 30 rastet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, me sipërfaqe totale 14157 m<sup>2</sup> llogaritur në vlerën **161,729,059 lekë**, në rastet kur këto sipërfaqe, posedohen nga më shumë se një individë dhe është e pamundur të konfigurohen parcela të veçanta ndërtimore, të bashkëpunohet me njësit e qeverisjes vendore dhe ZVRPP-në në terren, dhe të veprohet sipas kërkesave të nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 *“Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar.

2. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë edhe për periudhën në vazhdim, për çdo rast të ndërtimeve informale që shtrihen jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara, të llogarisë detyrimin për pagesë në sipërfaqet e poseduara të parcelave mbi 500 m<sup>2</sup>, me çmimet e tregut, në zbatim të nenit 17, pika 1, e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 *“Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”*.

3. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lezhë, të njoftojë zyrtarisht Bashkinë Lezhë dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces, për 6 (gjashtë) raste legalizimesh të ndërtimeve informale në troje të cilat kanë qenë kaluar në pronësi të Bashkisë Lezhë, me VKM nr. 414, datë 11.07.2007, *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, për transferimin, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Lezhë, të Qarkut Lezhë. Për këto objekte kanë filluar procedurat e inventarizimit nga Bashkia Lezhë që në vitin 2000, para datave të vetëdeklarimeve nga aplikuesit për legalizim të ndërtimeve informale. Objektet sa sipër, kanë numra pasurie: 10/364, 10/381, 10/378, 10/360, 10/180, 10/194.*

4. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të rakordojë me 5 bashkitë dhe 16 komunat e Qarkut Lezhë, për pronat e paluajtshme (troje dhe ndërtesa) të kaluara në inventarë pronësie të njëjësive të qeverisjes vendore me vendime të Këshillit të Ministrave, për të shmangur përplasjet mes vendimeve të KM.

5. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lezhë, për 663 raste aplikimesh të cilat i përkasin ndërtimeve pa leje në zona arkeologjike dhe zona bregdetare, për të cilat nuk është plotësuar aktkualifikimi dhe janë jashtë zonave, objekt veprimi i ligjit për ALUIZNI-n, të skualifikohen (të përjashtohen nga legalizimi), në zbatim të VKM nr. 515, datë 13.05.2009, “Për përcaktimin afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, të ndryshuar pika 3.2.

6. ALUIZNI Qarkut Lezhë, në përmbushje të funksioneve të veta, të hartojë skicat fushore në konfiguracion me përmasat reale e që përputhen me konfiguracionin e parcelës së pasqyruar në ortofoton digjitale dhe në hartën vektoriale, sipas Manualit të ALUIZNI-t, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008 “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (gen-plan, ortofoto, planimetri) të objektit që legalizohet.

7. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që matjet për hartimin e procesverbaleve të konstatimit, të kryhen në vijueshmëri territoriale, bazuar në ndarjen e zonave kadastrale, duke përcaktuar rast pas rasti nevojën ose jo që për parcela ndërtimore mbi 500 m<sup>2</sup> të konfigurohen parcela të veçanta për ndërtime, duke vendosur numra pasurie për pronë shtet për këto parcela dhe të inventarizohen dhe administrohen nga ALUIZNI Qarku Lezhë, si dhe të dërgohen në ZVRPP për regjistrim.

8. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lezhë, të marrë masa që në të ardhmen llogaritja për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë të bëhet bazuar në çmimin në fuqi në datën e dhënies së lejes së legalizimit, referuar vendimeve të Këshillit të Ministrave për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit **129,153 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, e cila përbëhet:

**B1.** Shpërblim dëmi për 6 (gjashtë) raste me vlerë **61,200 lekë**, për mos llogaritje të tarifës me gjobë për ditë vonesat në dorëzimin e vetë deklarimeve jashtë afateve ligjorë.

**B2.** Shpërblim dëmi për 69 raste me vlerë **67,953 lekë**, për llogaritje çmimi gabim, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, jo në përputhje me VKM nr. 4, date 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2011.

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 37 e nenin 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kontratës (kolektive) individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-it, që të fillojë procedura për;

### **“Zgjidhjen e kontratës së punës”**

1. **S.T.** me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Lezhë, aktualisht me detyrë specialist,

2. **B.B.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve,

### 3. N.C. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë,

Për shkeljet e dispozitave ligjore të konstatuara në legalizimin e ndërtimeve informale, pasi; Në kundërshtim me nenet 3, 17 dhe 20 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, janë zvogëluar parcelat ndërtimore gjatë procedurës së legalizimit, krahasimisht me sipërfaqet e zëna sipas vetë deklarimeve, ortofotove dhe skicave fushore që administrohen në dosjet e audituara, për 30 raste me sipërfaqeje totale prej 14157 m<sup>2</sup> në vlerë 161,729,059 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin për kompensimin e ish-pronarëve.

### D. KALLËZIM PENAL

**Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 561/9, datë 16.12.2013 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë:**

1. S.T. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Lezhë.
2. B.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve.
3. N.C. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.

Për **30 raste me vlerë 161,729,059 lekë** në kundërshtim me nenet 3, 17 dhe 20 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar janë zvogëluar parcelat ndërtimore gjatë procedurës së legalizimit, krahasimisht me sipërfaqet e zëna sipas vetëdeklarimeve, ortofotove dhe skicave fushore që administrohen në dosjet e legalizimeve.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Nga ALUIZNI Lezhë janë pranuar e vënë në zbatim rekomandimet e KLSH dhe është dërguar Plan masash për zbatimin e tyre me shkresë të protokolluar në KLSH nr. 561/11 datë 07.01.2014, pra rezulton se **rekomandimet janë pranuar**, dhe janë në marrë masat për zbatimin e tyre.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Pal Daçi, Hysen Metko, Mirosh Bogdo, Selman Hysa dhe Aleksandër Papadhimitri më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**